



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:036144

Datë: 19.07.2018

Numri i dokumentit: 00084723

P.nr. 390/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit T. A. G. nga fshati S., për shkak të veprës penale fallsifikim i dokumentave nga neni 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP/II.nr.1159-1/17 të dt. 26.05.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.18.07.2018, në prezencë të PSH Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. R. G., muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari T. G., nga i ati A., e ëma H. e lindur K., i lindur me dt. 05.03.1967 në fsh. S., invalid i luftës, i martuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, me numër personal, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 08.02.2017 rreth orës 20,30 minuta në Suharekë, saktësisht në Rr.”S.” përpilon dokument të falsifikuar ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, në atë menyre gjatë kontrolles rutinore nga ana e zyrtarve policor te i pandehuri deri sa e drejtonte automjetin e tij të markës “C.” me shenjen regjistruese 04-...-FK, tek i pandehuri është gjet patent shoferi me numër serik, i lëshuar në Republikën e Shqipëris i falsifikuar, në bazë të raportit të ekspertimit AKF/.....-...../2017-.... të dt. 15.03.2017, patent shoferi është i fallsifikur.

Këso dore ka kryer veprën penale fallsifikim i dokumentave nga neni 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KP.

Pranohet marrveshja mbi pranimin e fajsis PP/II.nr.1159-1/17 të dt. 26.05.2017 e lidhur mes prokurorit te Shtetit - Prokuroris Themelore në Prizren e nënshkruar nga Kryeprokurori

i Prokuroris Themelore dhe prokurori i qështjes në njëren anë dhe të akuzuarit T. G. dhe mbrojtësi av. R. G., në anën tjetër.

Gjykata në kuptim të neneve 43,46,73, si dhe nenit 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KP, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Të akuzuarit T. G. ia shqipton denimin me gjobë në shumë prej **300 € (treqind Euro)**, të cilin denim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi, poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me denim burgimi **prej 15 ditësh**, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burg, konform nenit 46 paragrafi 3 të KP.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € dhe taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 30 €.

A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzen PP/II.nr.1159-1/17 të dt.26.05.2017, ka akuzuar T. A. G. nga fshati S., për shkak të veprës penale fallsifikim i dokumentave nga neni 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KP, aktakuzen të cilin gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e tij e ka përfaqësuar PSH Musli Gashi, i cili në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, në përputhje me marrveshjen mbi pranimin e fajsis e cila i është bashkangjitur aktakuzes.

Të akuzuarin në këtë qështje penale e ka mbrojtur av. R. G., i cili në seancë për shqyrtimin e marrveshjes ka deklaruar se marrveshja është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve pa kurrfar ndërhyrje apo shtytje nga jashtë, pos vullnetit të lirë të shprehur nga vetë i akuzuari, andaj në përputhje me atë marrveshje kërkoi nga gjykata të akuzuarin të shpalle fajtor dhe të denoi në përputhje me marrveshjen.

I akuzuari gjithashtu në seancën për shqyrtimin e marrveshjes për pranim të fajsis ka deklaruar se ka qenë i vetëdijshem, i informuar me benificionet dhe pasojat e nënshkrimit të kësaj marrveshje dhe se me vullnetin e lirë në prani të mbrojtësit e ka nënshkruar i njëjti dhe ka heq dorë nga një gjykim i rregullt, ku do të administroheshin provat, në shkëmbim të një denimi me të butë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.18.07.2018 degjoi palet ku PSH ngeli si në aktakuzë dhe kërkoi nga gjykata të aprovoi marrveshjen mbi pranimin e fajsis dhe të akuzuarit ti shqiptoi denimin e propozuar në marrveshje të rekomanduar në piken III të marrveshjes, pasi që marrveshtja është nënshkruar me vullnetin e palëve dhe është në përputhje me nenin 233 pika 18 e KPP.

I akuzuari dhe avokati i tij gjithashtu kërkuan që gjykata të aprovon marrveshjen dhe ti shqiptoi denimin e rekomanduar në piken III të saj.

Gjykata ka vlersuar se marrveshja të pranohet pasi që e njëjta është në përputhje edhe me provat materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës nga Prokuroria e Shtetit dhe se e njëjta nuk është në kundërshtim me paragrafin 18 të nenit 233 të KPP dhe ka shqiptuar denimin e rekomanduar si në marrveshje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË,
P.nr.390/17 të dt.18.07.2018**

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.